

adoptuar të birin e të vëllait Abdullahut, Osmanin. Në datën 25.07.1998, forcat serbe i kanë zënë pozicionet në afërsi të Bellanicës/Belanica, ndërkaq i mbanin edhe pozicionet edhe në fshatin fqinj të Banjës/Banja. Selmani dhe Abdullahu me familjarë dhe banorë e braktisën fshatin dhe u strehuan në Dragobil/Dragobilje, ku qëndruan për 5 ditë në vazhdim. Pastaj, shumica prej tyre u nisën drejt Pagarushës/Pagaruša. Selmani, Abdullahu dhe Bajram Limaj nga Banja vendosen që të ktheheshin në **Bellanicë/Belanica**, për ta kontrolluar shtëpinë. Arritën në fshat në orët e mbrëmjes dhe natën e kaluan në shtëpinë familjare. Të nesërmen [1.09.1998], në mëngjes, Abdullahu dhe Bajrami konstatuan se Selmani po mungonte. E kërkuan rreth shtëpisë, por nuk e gjetën. Familja Kafexholli nuk kishte kurrfarë informacione për fatin e Selmanit deri në muajin tetor të vitit 1998, kur u kthyen në shtëpi. Banorët e kanë gjetur trupin e tij të pajetë në vreshtat e fshatit Banjë/Banja. Trupi i tij ishte i karbonizuar nga beli e te poshtë. Familjarët i kanë varrosur mbetjet mortore të Selmanit në afërsi të varrezave të Bellanicës/Belanica. Pas luftime, në muajin maj të vitit 2001, mbetjet mortore të Selmanit janë rivarrosur në varrezat e Bellanicës/Belanica.

Burimet: deklarata H.K, FDH-34635; *Mutilated Bodies of Albanians Found in Suhareka and Kaçanik*, pasqyra e lajmeve, KIC, 27.09.1998, FDH-34026; FHP, *Që njerëzit ti mbajnë në mend njerëz*, pyetësor, FDH-31242.

Skender (Azem) Januzi

(5.01.1970, shqiptar nga Seniku/Senik, komuna e Malishevës/Mališevo, bujk)

Skenderi me familje jetonin në periferi të Senikut/Senik. Në fund të muajit gusht të vitit 1998, ata u strehuan në pyll për shkak të bombardimit të fshatit. Pas disa ditësh, u rikthyen në shtëpi. Herët në mëngjes, më 1.09.1998, Skenderi me kushëririn Naserin kanë shkuar në Lladroc/Ladrovac, për t'i telefonuar të vëllait Muharremit, i cili jetonte në Gjermani. Kur u kthyen pasdite në **Senik**, Skenderi nuk i gjeti familjarët në shtëpi, sepse ata në ndërkohë kanë kaluar te

axha i Skenderit, Rrustemi. Skenderi u nis te shtëpia e axhës. Kur iu afrua shtëpisë së Rrustemit, një predhë e goditi shtëpinë dhe cifat e saj e plagosën Skenderin në shpinë dhe në këmbën e majtë. Familjarët e futën në bodrum dhe tentuan t'i jepnin ndihmë, por ai ndërroi jetë pas dy orësh. Në të njëjtën mbrëmje, Skenderin e kanë varrosur në pyll që gjendet te vendi i quajtur *Te Zabeli i Idrizit/Idrizov gaj*. Pas luftime, familjarët i kanë rivarrosur mbetjet mortore të Skenderit në varrezat e Senikut/Senik.

Burimet: deklarata Sh.J, FDH-33621; deklarata H.J, FDH-14779; deklarata Sh.S, FDH-3563; deklarata J.Z, FDH-3568; deklarata J.Z, FDH-3567; KMDLNJ, *Buletini*, num. 9, tetor-dhjetor 1998, 122, FDH-23857; *Serb Forces Renew Shelling of Senik, One Albanian Killed and two Wounded Tuesday*, pasqyra e lajmeve, KIC, 2.09.1998, FDH-29548.

Avdyl (Isen) Balaj

(12.12.1912, shqiptar nga Gllareva/Iglarevo, komuna e Klinës/Klina, pesë fëmijë)

Avdyli i moshëthyer me familje e kanë braktisur Gllarevën/Iglarevo në muajin prill të vitit 1998. Së pari shkuan në Vërmicë/Vrmnica, pastaj kaluan në Dush/Duësh [Klinë/Klina] dhe, më në fund, u strehuan në Panorc/Ponorac. Forcat serbe iu afruan këtij fshati më 2.09.1998. Banorët dhe refugjatët, në mesin e të cilëve edhe Avdyli me të birin Hasanin, të rejat Xhevahirën dhe Sevdijën me fëmijët e tyre, u strehuan në pyll, te vendi i quajtur *Boka e Panorcit/Ponorčev greben* [**Panorc/Ponorac**]. Hasani dhe burrat e tjerë u tërhoqën në thellësi të pyllit, përderisa Avdyli ndenji me gratë dhe fëmijët. Pjesëtarët e forcave serbe e zbuluan vendstrehimin e refugjatëve dhe u urdhëruan grave dhe fëmijëve që të nisën për në Dush/Duësh. Avdylin plak e kanë hipur në një traktor. Ishte kjo hera e fundit kur e reja Xhevahire e shihte atë të gjallë. Dy ditë më vonë, më 4.09.1998, Hasani u kthye në Panorc/Ponorac, ky e gjeti trupin e karbonizuar e të atit në traktor. E ka varrosur po atë ditë në varrezat e Dushit/Duësh. Pas luftime, mbetjet mortore të Avdylit u rivarrosën në varrezat e Gllarevës/Iglarevo.